

Këshilltare Ligjor në Gjykatën së Lartë

Aulona BODO u lind më 25 Shtator 1980. Në vitin 2004 ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Ka ushtruar profesionin e juristit në pozicionin e sekretarit gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, më pas ka vijuar si jurist pranë Shoqërisë Albtelekom sh.a, duke mbuluar përfaqësimet ligjore të kësaj kompanie në gjykatë. Në vijim ajo ka mbajtur pozicionin e Kryetarit të Degës Juridike pranë Universitetit të Tiranës, Rektorati. Nga muaji Janar 2008 deri në muajin nëntor 2012 ka punuar pranë Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, fillimisht si inspektor në Drejtorinë e Kthimit të Pronës, më pas Koordinator për çështjet e njohjes së kthimit dhe kompensimit të pronave në Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave për çështjet e njohjes dhe kthimit të pronave, dhe më pas, ka mbajtur detyrën e Përgjegjesit të Sektorit të Shqyrtimit për Çështjet e Njohjes dhe Kthimit të Pronave për tre qarqet Shkodër, Lezhë dhe Kukës. Në vitin 2013 ka punuar fillimisht si Specialist i Zhvillimit të Programeve të Granteve dhe më pas ka mbajtur pozicionin e Përgjegjesit të Sektorit të Zhvillimit të Programeve të Granteve, Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Komunikimit në Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Në periudhën Shkurt-Nëntor 2014, Znj. Bodo ka qenë pjesë e grupit Task Forcës së ngritur “*Për verifikimin e ligjshmërisë dhe mënyrës së tjetërsimit të pronave të paluajtshme shtetërore*”, në cilësinë e ekspertes së nivelit të lartë të kontraktuar nga Qeveria Shqiptare për çështjet e pronësisë dhe regjistrimit të titujve të pronësisë. Nga muaji nëntor 2014 e në vijim, Znj. Bodo ka qenë ndihmëse ligjore pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, më pas Këshilltare Ligjore në Kabinetin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Znj. Bodo në vitin 2012 ka marrë Diplomën MASTER-Niveli i dytë në të Drejtën Civile, lëshuar nga Shkolla e Lartë Private “ILLYRIA”, Fakulteti i Drejtësisë. Në muajin Maj 2019, Znj. Bodo ka përfunduar me sukses programin SAL “School of American Law”, pranë *School of American Law*, Athen-Greece, cila përbën edhe fazën e parë të kualifikimi për të vijuar fitimin e titullit Master LL.M in “*U.S., International and Transnational Law*”, Chicago-Kent College of Law, Illinois Institute of Technology, USA .

Znj Bodo është angazhuar në veprimtaritë mësimdhënëse në vitin 2007 pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Fakulteti Biznes-Turizëm, Dega Drejtësi, Vlorë. Ajo zotëron gjithashtu edhe titullin “Avokat”.